



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:216345

Datë: 16.03.2022

Numri i dokumentit: 02810025

Pml.nr.107/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët:, kryetar kolegji, Agim Maliqi, Nesrin Lushta dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit, S. G. shtetas i Algjerisë , etj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit S. G. avokat Përparim Haliti nga P., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda Ppr.nr.114/2021 të datës 25.01.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për krime të rënda PN.1.nr.189/2022 të datës 15.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.03.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si jolëndore kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit S. G. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda Ppr.nr.114/2021 të datës 25.01.2022 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për krime të rënda PN.1.nr.189/2022 të datës 15.02.2022.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda, me aktvendimin Ppr.nr. 114/2021 të datës 25.01.2022, të pandehurit S. G., etj. ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ashtu që sipas këtij

aktvendimi paraburgimi do t'i zgjasë deri më datë 26.02.2022. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 dhe nenit 188, 189 dhe 191 të KPP.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr. 189/2022 të datës 15.02.2022, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit S. G., dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit S. G., av. Përparim Haliti për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovtojë si të bazuar kërkesën, ti ndërpret masën e paraburgimit, ose ti anulojë aktvendimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.40/2022 e datës 16.03.2022, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të hudhet si jolëndore.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është jo lëndore.

Duke pas parasysh faktin se, në bazë të shkresave të lëndës, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimeve të kundërshtuara, në këtë gjykatë është pranuar me datë 15.03.2022, d m th pasi që të pandehurit i ka skaduar afati i vazhimit të paraburgimit (paraburgimi ka qenë i vazhduar deri më datë 16.02.2022), andaj kjo gjykatë vlerëson se kërkesa nuk mund të jetë objekt shqyrtimi dhe si e tillë është jolëndore sepse pavarësisht shkeljeve të pretenduara në kërkesë i pandehuri e ka mbajtur paraburgimin për atë kohë sa ka qenë i vazhduar me vendimin e kundërshtuar, të cilit i ka skaduar afati.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 435 par.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.107/2022, më datë 16.03.2022

B.Profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi